



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Nr. 476/5 Prot.

Tiranë, më 27.06.2016

V E N D I M

Nr.66, Datë27.06.2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË KRYER NË
AGJENCINË E BASENIT UJOR ISHËM ERZEN TIRANË "MBI ZBATIMIN
E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRIËSË EKONOMIKO
FINANCIARE".**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkzionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko financiare”, të ushtruar në ABU Ishëm Erzen Tiranë, për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2015.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetjet nga auditimi: Agjencia e Basenit Ujor (ABU) Ishëm- Erzen ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në lidhje me zhdëmtimin e shumës **51,272,386** lekë, përkatësisht: në 7 raste nga “Ujësjetllës Kanalizime” sha në shumën 48,344,081 lekë dhe në 5 raste nga subjekte përdorues të rezervës ujore në shumën 2,197,885 lekë, për të cilat, Agjencia e Basenit Ujor në mungesë të kapaciteteve financiare e juridike nuk ka mundur të bëjë arkëtimin e tyre, megjithëse ka dërguar të gjitha dosjet e subjekteve debitorë në Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore, në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, e cila do të zbatojë këtë rekomandim, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, në përputhje me përcaktimet në shkronjën **j** dhe **k** neni 15 dhe neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 7-9, të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me Agjencinë e Basenit Ujor Ishëm-Erzen Tiranë të zbatojë rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e mëparshëm, të kërkojnë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **51,272,386 lekë** nga subjektet përdorues të rezervës ujore të konstatuar si debitorë, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjithë shkallët e gjykimit deri ato përmbarimorë.

Brenda datës 31.08.2016

2- Gjetje nga auditimi: Nga mosplotësimi me akte nënligjore të ligjit nr. 111/12, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” dhe mos funksionimit të Këshilli i Basenit Ujor (KBU) Ishëm-Erzen, nuk është arritur menaxhimi, administrimi i plotë dhe efektiv, i rezervave ujore të Basenit Ishëm- Erzen, si dhe *nuk është hartuar dhe miratuar Projekt plani i Menaxhimit të Basenit*, sipas përcaktimeve në shkronjat ”a” dhe “b” pika 2, neni 13, të Ligjit nr. 111/12, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen, në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse, të marrin masa për të hartuar dhe miratuar Projekt planin e Menaxhimit të Basenit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Ujit.

Në vijimësi

3- Gjetje nga auditimi: Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen nuk ka funksionuar normalisht, për rrjedhojë *nuk ka marrë vendime për miratim leje të përdoruesve të ujit*, duke ndikuar në kufizimin e ushtrimit të detyrave të ABU Ishëm-Erzen, pasi *nuk ka patur nxitje të përdoruesve të ujit*, sipas përcaktimeve në shkronjën ”d” pika 2, neni 13 të Ligjit nr. 111/12, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Agjencia e Basenit Ujor Ishëm-Erzen në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të marrë masa, duke vënë në dijeni strukturat qendrore të menaxhimit të ujërave për gjendjen në të cilën ndodhet Baseni Ujor Ishëm Erzen, me qëllim që të sigurohet një funksionim normal i KBU Ishëm Erzen, për të bërë të mundur zhblokimin e miratimit të lejeve dhe të mundësohet një nxitje e vazhdueshme e përdoruesve të ujit.

Në vijimësi

4- Gjetje nga auditimi: Në mungesë të akteve nënligjore dhe periudhës së gjatë të riorganizimit të strukturave, *nuk janë hartuar dhe miratuar programe të përbashkëta me Agjencinë Rajonale të Mjedisit*, lidhur me parandalimin dhe shmangien e ndotjeve të burimeve ujore, sipas përcaktimeve në pikën 1 neni 30, të Ligjit nr. 111/12, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: ABU Ishëm-Erzen të rrisë bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Mjedisit dhe struktura të tjera përkatëse dhe të marrë masa për të *hartuar dhe miratuar programe pune të përbashkëta*, për të bërë të mundur mbrojtjen e mjedisit dhe shmangien nga ndotjet të burimeve ujore.

Në vijimësi

5- Gjetje nga auditimi: Mungesa e akteve nënligjore, veçanërisht mungesa e miratimit të tarifave për shkarkimet e lëngëta të prodhuara nga trajtimi i ujërave të përdorura industriale, ka ndikuar në mos identifikimin e subjekteve që kryejnë veprimtarinë e shkarkimeve të lëngëta, sipas përcaktimeve në pikën 3 e pikën 5 neni 30, të ligjit nr. 111/12, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: ABU Ishëm-Erzen të marrë masa për të evidentuar subjekte që kryejnë veprimtari të shkarkimeve të lëngëta, të prodhuara nga trajtimi i ujërave të përdorura industriale dhe pas miratimit të tarifave nga organet përkatëse, të ndjekë në vazhimesi arkëtimin e tyre nga subjektet që kryejnë këtë lloj veprimtarie.

Në vijimësi

6- Gjetje nga auditimi: Mungon formati TIP për lidhjen e kontratave koncesionare, për rrjedhojë ABU Ishëm Erzen *nuk ka lidhur kontratat përkatëse* për përdorimin e ujit nga subjektet sh.a Ujësjiellës kanalizime Kamëz, sh.a Ujësjiellës kanalizime Krujë dhe sh.a Ujësjiellës kanalizime Fushë-Krujë, megjithëse këto janë të evidentuar ndër vite si përdorues të ujit, duke u ngarkuar me debi për mos shlyerje të detyrimeve ndaj ABU-së, veprim në mospërputhje me nenin 14, të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për Rezervat Ujore”, i ndryshuar (për periudhën deri më 15.12.2013) dhe me pikën 1 neni 41, ligjit nr. 111/12, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe KBU Ishëm Erzen në bashkëpunim me ABU Ishëm Erzen, të marrin masa dhe të ndjekin të gjitha hapat ligjorë, për të bërë të mundur realizimin e lidhjes së kontratave me subjektet sh.a Ujësjiellës kanalizime

Kamëz, sh.a Ujësjetllës kanalizime Krujë dhe sh.a Ujësjetllës kanalizime Fushë-Krujë, të evidentuar si përdorues të ujit.

Në vijimësi

7- Gjetje nga auditimi: ABU Ishëm Erzen ka evidentuar një numër të madh subjektësh privatë që përdorin ujin në mënyrë të paligjshme, por rezulton se *për shkak të mungesës së akteve nënligjore, nuk është bërë e mundur pajisja e tyre me Leje për përdorimin e ujit, sipas përcaktimeve në pikën 1 neni 41, ligjit nr. 111/12, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” (Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim: ABU Ishëm Erzen në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore, në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të marrin masa për të përgatitur dokumentacionin tekniko ligjor për të gjithë subjektet, që kanë aplikuar për tu pajisur me leje, duke e dërguar për shqyrtim në mbledhjen më të afërt që do të zhvillojë KBU Ishëm Erzen, pas konstituimit të saj, për të marrë vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore.

Brenda datës 31.10.2016

8- Gjetje nga auditimi: ABU Ishëm Erzen ka kërkuar vazhdimisht që të instalohen matësit e ujit nga 3 subjektet: sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Durrës dhe sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Kavajë, të cilat *nuk kanë zbatuar kërkesat dhe kushtet e kontratës dhe lejes së përdorimit të ujit, duke mos instaluar matësit e ujit, duke ngritur pretendimin se në disa kaptazhe është teknikisht e pamundur për ti instaluar ato, për rrjedhojë janë faturuar në bazë të deklaratimit të tyre për sasinë e ujit që përdorin, veprim në papajtueshmëri me geramat “ç”, “d” pika 2 neni 53, të Ligjit nr. 111/12, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” (Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim: ABU Ishëm Erzen në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të marrë masa, duke ngritur grup pune, që të ketë në përbërje specialistë të fushës, për të argumentuar teknikisht mundësinë ose pamundësinë e instalimit të matësve të ujit, në të gjitha burimet ujore që pretendohet pamundësia teknike e instalimit të tyre dhe bazuar në relacionin teknik të paraqitur, të veprohet dhe të realizohet instalimi i matësve të ujit nga subjektet sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Durrës dhe sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Kavajë, për të shmangur abuzimet gjatë përdorimit të ujit.

Brenda datës 31.10.2016

9- Gjetje nga auditimi: Matësit të ujit që janë instaluar nga subjektet përdorues të ujit, *nuk janë të pajisur me certifikatë apo raport testimi, të lëshuar nga institucionet përkatëse të autorizuar për kolaudimin e instrumenteve matës, me qëllim garantimin e saktësisë së matjes gjatë përdorimit të tyre (Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim: ABU Ishëm Erzen në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të marrë masa dhe të kërkojë që subjektet e pajisura me leje për përdorimin e

ujit, përpara se të instalojnë matësin e ujit, të paraqesin tek Agjencia e Basenit dokumentacionin tekniko ligjor, që vërteton se matësi ka kaluar procedurën e kolaudit dhe përmbush kushtet teknike për tu vënë në përdorim. Në të kundërt të kërkohet pezullimi i lejes që disponon subjekti përkatës.

Brenda datës 31.10.2016

10- Gjetje nga auditimi: ABU Ishëm Erzen nuk ka të miratuar nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, një model standard të dokumenteve, që ta përdorë gjatë ushtrimit të aktivitetit për monitorimin dhe kontrollin e subjekteve. Përdorimi i një modeli të tillë ndikon në rritjen e cilësisë dhe transparencës, gjatë ushtrimit të aktivitetit nga punonjësit e ABU-së (*Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me ABU Ishëm Erzen, të marrë masa për të hartuar dhe miratuar dokumente standarde, për të pasqyruar të dhënat kryesore dhe rezultatet e kontrollit e monitorimit të subjekteve, përfshirë të dhënat që përmban leja e përdorimit që disponon subjekti, si dhe referencën ligjore mbi të cilën mbahet akti.

Brenda datës 31.10.2016

11- Gjetje nga auditimi: ABU Ishëm Erzen gjatë ushtrimit të aktivitetit, nuk ka patur mbështetjen e duhur nga strukturat qendrore të varësisë, pasi nuk ka në dispozicion mjete motorike të nevojshme dhe as infrastrukturë tjetër ndihmëse, për të bërë të mundur monitorimin e Basenit në të gjithë shtrirjen gjeografike, duke ndikuar në funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të Agjencisë së Basenit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe strukturat e tjera kompetente të marrin masa për të pajisur ABU Ishëm Erzen me mjete dhe infrastrukturë teknike të nevojshme, për të monitoruar me efikasitet dhe efektivitet Basenin ujor në të gjithë shtrirjen e tij.

Brenda datës 31.10.2016

12- Gjetje nga auditimi : ABU Ishëm-Erzen gjatë ushtrimit të aktivitetit, ka ndjekur në vazhdimësi arkëtimin e tarifave të përdorimit të ujit nga subjektet përkatëse, duke kërkuar edhe mbështetjen e strukturave të tjera, por mungesa e këtij bashkëpunimi dhe mungesa e mbështetjes me mjete motorike, e ka bërë të pamundur arkëtimin e plotë të tarifave, për rrjedhojë është krijuar mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit, në vlerën 3,209,417 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, si struktura kryesore e varësisë, të marrë masa për të mbështetur në vazhdimësi aktivitetin e ABU Ishëm Erzen dhe në bashkëpunim të marrin masa, duke kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 3,209,417 lekë, nga subjektet përdorues të rezervës ujore të konstatuar si debitorë dhe

të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit deri ato përmbarimorë .

Brenda datës 31.10.2016

B. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHET

Gjetje nga auditimi : Nga mos funksionimi i mekanizmave ligjorë dhe nxitja e operatorëve në përdorimin e ujit, për shkak të mungesës së ecurisë me ritmet e duhura të proceseve reformuese, këtij institucioni i janë krijuar të ardhura të munguara në buxhet, në vlerën **54,481,803 lekë**, ndarë si më poshtë:

a. Vlera prej **51,272,386** lekë, që i përket periudhës së mëparshme, përkatësisht: në 7 raste Ujësjes Kanalizime në shumën 48,344,081 lekë dhe 5 raste subjekte përdorues të rezervës ujore në shumën 2,197,885 lekë, për të cilat, Agjencia e Basenit Ujor në mungesë të kapaciteteve financiare e juridike nuk ka mundur të bëjë arkëtimin e tyre, megjithëse ka dërguar të gjitha dosjet e subjekteve debitorë në Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore, në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ka kërkuar ndjekjen e vazhdimin e procedurave.

b. vlera prej **3,209,417** lekë, që i përket ushtrimit të aktivitetit në periudhën viti 2013-2015, për të cilën nuk është bërë i mundur arkëtimi i plotë i vlerës së tarifave, me gjithë punën e bërë për ndjekjen në vazhdimësi dhe kërkimin e mbështetjes nga strukturat të tjera bashkëpunuese, bashkëpunim i cili nuk është arritur, si dhe ka munguar mbështetja me infrastrukturën teknike të nevojshme, gjendje kjo në mos përmbushje të kërkesave të nenit 94 të ligjit nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” dhe të akteve nënligjore (*Trajtuar më hollësisht në faqet 27-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore në Ministrinë Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në bashkëpunim me ABU Ishëm-Erzen Tiranë, të marrë masa për shpejtimin e vënien në funksion të mekanizmave, nxitjen e operatorëve në përdorimin e ujit dhe shpejtimin e ritmeve të ecurisë së proceseve reformuese, si dhe të ndjekë të gjitha hapat e duhur administrativë e ligjorë për kërkimin, arkëtimin dhe vënien në efikasitet të vlerës prej **54,481,803 lekë**, e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit.

C. TË TJERA

Duke e konsideruar menaxhimin dhe mbrojtjen e rezervave hidrike, si një prioritet shumë të rëndësishëm që ndikon në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve, nisur nga problemet e konstatuara gjatë auditimit të ABU Ishëm Erzen Tiranë lidhur me funksionimin e kapaciteteve institucionale për t’u përgjigjur me efektivitet dhe efikasitet kërkesave në rritje për përdorimin e rezervave hidrike, shfrytëzimin në maksimum i burimeve ujore dhe mbrojtjen e tyre nga ndotjet, si dhe nga mungesa e strategjive e planeve menaxhuese dhe monitoruese nga institucionet përgjegjëse për përdorimin e rezervave ujore dhe identifikimin e kontrollin e faktorëve të riskut, Kontrolli i Lartë i Shtetit do të zhvillojë një auditim performance, që do të

përfshijë të gjithë strukturat, që kanë detyrimin dhe përgjegjësinë institucionale për menaxhimin dhe monitorimin e burimeve ujore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R